




KUVENDI I KOMUNËS SË GJAKOVËS

Raporti i Punës së Kuvendit

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Dječkovića - Municipality of Gjakova

ARKIVA HYRËSE
UVODNI ARHIV
INTRODUCTORY ARCHIVES

Njësi • O.J.U. " 01-052/01-7600
Numeri/Br. No. Nr. Bevešt. Str. No. Pg.

Data/Datum/Date 12.02 Pranoj/Prizvat/Accept 2026
Gjakovë - Gjakovica - Gjakova

Janar - Gusht 2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Përmbledhje nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Në cilësinë time si Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, ju paraqes këtë raport mbi punën institucionale dhe progresin e arritur gjatë vitit kalendarik 2025. Periudha raportuese, që përfshin muajt janar deri në gusht, pasqyron një përkushtim të vazhdueshëm ndaj qeverisjes demokratike, transparencës dhe dialogut konstruktiv ndërmjet të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi i Komunës ka ruajtur vazhdimësinë institucionale përmes mbajtjes së seancave të rregullta, shqyrtimit të dokumenteve strategjike dhe marrjes së vendimeve me ndikim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e qytetarëve tanë. Megjithëse dinamika politike dhe mospajtimet kanë qenë të pranishme në disa raste, Kuvendi ka funksionuar në frymën e llogaridhënies, gjithëpërfshirjes dhe përgjegjësisë ndaj detyrimeve të tij kushtetuese dhe ligjore. Puna e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) ka qenë thelbësore në filtrimin e çështjeve kyçe të politikave dhe buxhetit përpara se ato të diskutoheshin në seancat e Kuvendit, duke mundësuar një debat më të informuar dhe më të strukturuar. Si Kryesuese, kam inkurajuar në vazhdimësi respektimin e Rregullores së Punës, pjesëmarrjen e barabartë të anëtarëve dhe kam theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional. Për më tepër, bashkëpunimi i Kryesueses, si përfaqësuese e Kuvendit, me komunat e Kosovës, Shqipërisë, Italisë dhe Malit të Zi, si dhe me institucione ndërkombëtare të njohura si OSBE, NDI, UNDP, UN Women e të tjera, ka qenë i shkëlqyer dhe ka kontribuar në përf forcimin e kapaciteteve institucionale dhe në shkëmbimin e përvojave më të mira për një qeverisje lokale më efektive dhe transparente.

Kuvendi i Komunës vazhdon të jetë një forum i rëndësishëm për dialog ndërmjet ekzekutivit, qytetarëve dhe zyrtarëve që mbajnë poste politike. Ky raport është pjesë e përpjekjeve tona të vazhdueshme për të mbajtur publikun të informuar dhe për të siguruar që veprimet tona të jenë transparente dhe të përgjegjshme.

Gjatë këtij viti Kuvendi i Komunës së Gjakovës i ka shqyrtuar gjithsej 59 pika të rendit të ditës, dhe ka miratuar 21 akte nga të cilat 17 vendime dhe 4 rregullore.

Kuvendi i Komunës së Gjakovës ka mbajtur 8 mbledhje të rregullta, 1 mbledhje solemne të përbashkët me Bashkinë e Sarandës për nder të Pavarësisë së Kosovës, 1 mbledhje solemne për nder të Epopesë së UÇK-së dhe një mbledhje solemne të përbashkët me Bashkinë e Tropojës.

Funksionimi i Komiteteve tjera dhe Komiteteve Këshillëdhënëse

Ndërkohë që KPF-ja ka vazhduar të përmbushë përgjegjësitë e tij përmes shqyrtimit të çështjeve kyçe financiare dhe të politikave para seancave të Kuvendit, aktiviteti i përgjithshëm i komiteteve të tjera funksionale dhe atyre këshillëdhënëse ka qenë i kufizuar dhe nën nivelin e pranueshëm gjatë kësaj periudhe raportuese. Megjithëse janë themeluar formalisht dhe u janë caktuar fusha të caktuara të mbikëqyrjes, këto trupa nuk janë mbledhur në mënyrë të rregullt dhe nuk kanë dhënë kontribut efektiv në procesin institucional të vendimmarrjes.

Ky nivel i ulët i funksionalitetit lidhet kryesisht me mungesën e pjesëmarrjes së anëtarëve të komisioneve, shumë prej të cilëve janë prekur drejtpërdrejt nga zbatimi i Ligjit për Pagat. Mungesa e kompensimit financiar për angazhimin në punën e komisioneve ka ndikuar negativisht në gatishmërinë e anëtarëve për të marrë pjesë, duke cenuar kështu rolin e tyre funksional dhe duke reduktuar ndikimin në proceset e shqyrtimit të politikave, monitorimit dhe mbikëqyrjes. Si Kryesuese, këtë çështje e kam adresuar vazhdimisht në forume përkatëse, duke theksuar nevojën për zgjidhje institucionale që do të siguronin funksionalitetin dhe angazhimin e plotë të të gjitha

komisioneve, në mënyrë që ato të jenë në shërbim të plotë të punës së Kuvendit të Komunës në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe substanciale.

Sfidat në funksionimin e Kuvendit të Komunës

Puna e Kuvendit të Komunës është sfiduar minimalisht në mbarëvajtjen e tij të rregullt. Gjatë këtij viti, anëtarët e Kuvendit kanë munguar gjithsej (54) herë, prej të cilave (26) mungesa pa arsye dhe (28) me arsye të arsyetuara. Përveç mungesave, sfidë e përsëritur ka qenë mosrespektimi i vazhdueshëm i Rregullores së Punës, veçanërisht duke ndërhyrë pa leje gjatë fjalimeve, rrjedhimisht, duke ndikuar kështu në pikat e rendit të ditës e diskutimeve.

Vonesat e shpeshta, largimet para përfundimit të seancave, mungesat pa paralajmërim, si dhe mos prezenca në sallë gjatë zhvillimit të punimeve të Kuvendit janë vërejtur në disa raste.

Atmosfera politike dhe roli i Kryesueses

Atmosfera politike në Kuvendin e Komunës gjatë periudhës raportuese ka qenë përgjithësisht e balancuar dhe konstruktive, pavarësisht diversitetit të qëndrimeve politike mes anëtarëve të Kuvendit. Kjo ka qenë në masë të madhe rezultat i udhëheqjes së qëndrueshme dhe paanshme nga ana e Kryesueses, e cila ka ofruar qasje bashkëpunuese në menaxhimin e agjendës dhe diskutimeve brenda Kuvendit. Ky përkushtim për të ruajtur integritetin institucional, për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë anëtarët dhe për të krijuar hapësirë për dialog gjithëpërfshirës, ka kontribuar ndjeshëm në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe funksional. Si Kryesuese, theks të veçantë janë mbështetur iniciativave që adresojnë interesin publik dhe promovojnë të drejtat e njeriut, përfshirë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara, këshillat lokale dhe komunitetet. Përmes kësaj qasjeje gjithëpërfshirëse të udhëheqjes, është kultivuar një frymë transparence, llogaridhënieje dhe respekti të ndërsjellë, si në mbledhjet formale të Kuvendit ashtu edhe në angazhimet ndër-institucionale. Në pozitën e Kryesueses së Kuvendit, thelbësore ishte vendosja e normave të debatit të përqendruar në çështje substanciale dhe në funksionin thelbësor të Kuvendit për të shërbyer interesit të përgjithshëm.

Krahas sfidave të pranishme, veçanërisht në funksionalizimin e komisioneve dhe pjesëmarrjen e anëtarëve, performanca e përgjithshme e Kuvendit është pasqyruar me shembuj pozitiv për komunat e tjera. Përvoja e Kuvendit të Komunës të Gjakovës gjatë këtij viti kalendarik pasqyron përkushtimin ndaj pjekurisë institucionale, gjithëpërfshirjes dhe qeverisjes pjesëmarrëse. Ky përkushtim ndaj transparencës e llogaridhënies publike le pas vetes një praktikë të qëndrueshme dhe të efektshme, që shtrihet përtej Gjakovës dhe shërben si model në peizazhin më të gjerë komunal.

Arbënesha Kuqi

Kryesuese e Kuvendit të Komunës

